Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/400
Datë: 20.08.2021

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe, Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve qe ofrojnë kualifikime ne Kosove, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 20.08.2021 nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. Akreditohet institucioni "Kolegji ISPE" SH.P.K., me adresë: Rruga "Besim Ndreca", nr. 19, Prishtinë, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 01.09.2021 deri me 31.08.2024 me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):
   1.1. **BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL I INFERMIERISË,** Niveli III dhe IV sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar i Kombinuar (C) me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin arsimit dhe aftësimit profesional me nga njëzetepesë (25) nxënës brenda një klase për orët e mësimit teorik, dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në tre (3) paralele. Ndërsa praktika profesionale realizohet me nga gjashtë deri në tetë (6-8) nxënës brenda një grupi.
   1.2. **TEKNIK DENTAR,** Niveli III dhe IV sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar i Kombinuar (C) me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e arsimit dhe aftësimit profesional me nga njëzetepesë (25) nxënës brenda një klase dhe gjatë një viti mund të mbahen dy (2) paralele.

2. **Refuzohet** akreditimi i institucionit "Kolegji ISPE" SH.P.K, me adresë: Rr. Bedri Pejani, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës, për kualifikimin: **ASISTENT I KUJDESIT SOCIAL-SHËNDETËSOR,** niveli (III) sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar i Kombinuar (C) me 163 kredi të AAP.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucioni "Kolegji ISPE" SH.P.K., me adresë: Rruga "Besim Ndreca", nr. 19, Prishtinë, Republika e Kosovës, për validim dhe akreditim të institucioni dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi validimin e kualifikimit, si dhe Raporti i ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për validim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv lidhur me pikën një (I) si në dispozitivin e këtij vendimi, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje.

Ekipi i jashtëm i ekspertëve me datë 13 korrik 2021 ka shqyrtuar dokumentacionin e institucionit "Kolegji ISPE", ndërsa me datë 15 korrik 2021 ka vizituar institucionin "Kolegji ISPE" lidhur me aplikimin për akreditim dhe validim për kualifikimin Asistent i Kujdesit Social Shëndetësor.

Në raportin e akreditimit në piken ku trajtohet "**Vlerësimi i përgjithshëm për institucionin aplikues për ofrim, vlerësim dhe certifikim"**, ekspertët vlerësojnë se: Objekti, në përgjithësi nuk ka salla me kapacitete optimale me pajisje të caktuara mbështetëse, Megjithatë sallat apo hapësirat për profilin "Asistent i Kujdesit Social Shëndetësor" nuk janë caktuar, prandaj nuk ka kushte për zhvillimin e këtij kualifikimi. Pjesa dërmuese e stafit të paraparë për mbajtjen e mësimit nuk i plotësojnë kriteret sipas normativit për mësimdhënësit e arsimit profesional të nxjerrë nga Ministria e Arsimit, por edhe nuk kanë përvojë në fushën që mbulojnë. Po ashtu shumica e stafit të paraparë për mësimdhënie janë të me orar të pjesshëm dhe kjo paraqet një pengesë shtesë sepse orari i rregullt i punës së tyre mund të përkojë me orarin e mësimit.

Në raportin e akreditimit në piken ku trajtohet "**Komentet për cilësinë e të dhënave të paraqitura dhe dokumenteve përkatëse"**, ekspertët vlerësojnë se: Gjatë shqyrtimit të dokumenteve të paraqitura, por edhe gjatë takimit me menaxhmentin e institucionit janë diskutuar çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me cilësinë e të dhënave dhe janë kërkuar

dëshmi shtesë për disa nga dokumentet që përshkruajnë proceset e caktuara. Një pjesë e dëshmive që kanë të bëjnë me çështjet e përgjithshme të institucionit janë dorëzuar, kurse pjesa e dëshmive që lidhen ngushtë me kualifikimin "Asistent i Kujdesit Social Shëndetësor" nuk janë dorëzuar.

Në raportin e akreditimit në piken ku trajtohet "**Resurset e nevojshme materiale dhe pajisjet për ofrim, vlerësim dhe certifikim**", ekspertët vlerësojnë se: Institucioni gjatë kohës së vizitës nuk ka dëshmuar se ka pajisje dhe materiale për ofrim, vlerësim dhe certifikim siç parashihet në standardin e profesionit dhe në programin për "Asistent i kujdesit social shëndetësor". Në program janë paraparë: laborator i pajisur me mikroskop dhe mullazhe, media didaktike si video projektor, flip chart, katalogë, atlas anatomik, CD, mjedise reale pune në sektorin e shëndetësisë ku kryhen higjienizime, sterilizime dhe dezinfektime, instrumente për matjen e shtypjes së gjakut, aparate për matjen e rrjedhjes së ajrit (peak flow metter), mostra të materialit shpenzues për pastrim dhe dezinfektim, mjete të ndihmës së parë për emergjenca të vogla dhe të tjera, por që nuk janë dëshmuar se ekzistojnë.

Në raportin e akreditimit në piken ku trajtohet "**Stafi i nevojshëm për ofrim, vlerësim dhe certifikim**", ekspertët vlerësojnë se: Gjatë ditës së vizitës ekipi është takuar me 4 nga mësimdhënësit e paraparë për të mbajtur mësim në profilin "Asistent i Kujdesit Social Shëndetësor". Pjesa dërmuese e stafit të paraparë për mbajtjen e mësimit nuk i plotësojnë kriteret sipas normativit për mësimdhënësit e arsimit profesional të nxjerrë nga Ministria e Arsimit (neni 13, pika 15), por edhe nuk kanë përvojë në fushën që mbulojnë. Po ashtu shumica e stafit të paraparë për mësimdhënie janë të me orar të pjesshëm dhe kjo paraqet një pengesë shtesë sepse orari i rregullt i punës së tyre mund të përkojë me orarin e mësimit.

Në raportin e akreditimit në piken ku trajtohet "**Kërkesat tjera të veçanta të kualifikimit (projekte, detyra, marrëveshje me punëdhënësit, etj.)**", ekspertët vlerësojnë se: Për të rritur cilësinë e punës profesionale, shkolla ka vazhduar bashkëpunimin duke arritur disa marrëveshje të caktuara. Në bazë të vlerësimeve dhe shqyrtimit të dëshmive që ka paraqitur institucioni, mësimdhënësit kanë detyra dhe projekte të mjaftueshme për vlerësime, por realizimi i punës praktike dhe vlerësimi nëpër institucione të tjera nuk është përshkruar dhe nuk ka dëshmi të mjaftueshme se si do të ndodh. Gjithashtu, mungojnë dëshmitë e marrëveshjeve për punë praktike jashtë shkollës.

Në raportin e akreditimit në piken ku trajtohet "**Dokumentacioni dhe të dhënat që mbështesin sigurimin e cilësisë dhe verifikimin e të arriturave të nxënësit/kandidatit**", ekspertët vlerësojnë se: Janë ofruar të dhëna që mbështesin sigurimin e cilësisë dhe verifikimin e të arriturave të nxënësve përmes mostrave të portfoliove të nxënësve me të dhënat e nevojshme për të matur të arriturat e tyre, si: raporte ditore për vijueshmërinë, raporte për orët e mbajtura, testi hyrës, testet modulare dhe testi përfundimtar. Megjithatë panelit nuk i janë ofruar dëshmi të mjaftueshme lidhur me sistemin e të dhënave për verifikimin e të arriturave individuale, regjistrimet, dokumentimi i dëshmive, rezultatet e vlerësimit dhe të dhëna të tjera që lidhen me monitorimin dhe vlerësimet e pjesës praktike jashtë shkollës.

Në raportin e akreditimit në piken ku trajtohet "**Politikat dhe procedurat për vlerësimin e kandidatëve me aftësi të kufizuara**", ekspertët vlerësojnë se: Institucioni nuk ka ofruar ndonjë dëshmi, politikë apo procedurë për vlerësimin e nxënësve me aftësi të kufizuara. Panelit i është thënë që do të merret parasysh krijimi i rrethanave të veçanta nëse paraqitet nevoja.

Këshilli Drejtues i AKK-së mbështetur në raportin e ekspertëve vlerësues lidhur me validimin dhe akreditimin e institucionit "Kolegji ISPE" lidhur me aplikimin për akreditim dhe validim për kualifikimin Asistent i Kujdesit Social Shëndetësor, niveli (III) sipas KKK, me 163 kredi të AAP, mbështetur në të gjeturat e eksperteve të dhëna në: Raportin vlerësues për validim dhe Raportin vlerësues për akreditim vendosi si në piken dy (II) të dispozitivit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Kolegji ISPE, dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar KD së AKK